

VENDIM
Nr.588, datë 5.9.2007

**PËR SHPËRNDARJEN, ME KOEFICIENT, TË VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE
TË SHOQËRISË “GJALLICA” SHPK, NË ADMINISTRIM, ME TË ARDHURAT E
REALIZUARA NGA SHITJA E ASETETEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, sipas koeficientit të kthimit të shumave, në masën 2.41 për qind, të llogaritur si raport i të ardhurave, të realizuara dhe të depozituara në bankë, nga shitja e asetëve, e gjendjeve të llogarive bankare të kësaj shoqërie, të trashëguara, me shumën e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse ka ndaj kreditorëve.

1.1 Të ardhurat financiare, të realizuara nga shitja e asetëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, dhe të depozituara në bankë janë në shumën 937 076 530 (nëntëqind e tridhjetë e shtatë milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë.

1.2 Shuma e detyrimit të mbetur, që shoqëria huamarrëse “Gjallica” sh.p.k., në administrim, ka ndaj kreditorëve është 38 790 326 573 (tridhjetë e tetë miliardë e shtatëqind e nëntëdhjetë milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

2. Koeficienti i kthimit të kreditorëve është 2.41 për qind.

3. Shpërndarja e vlerave financiare të kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, në rrethet Tiranë e Vlorë, të kryhet nga Banka Kombëtare Tregtare, Tiranë. Rregullat e hollësishme për mënyrën, kohën dhe radhën e shlyerjes së kreditorëve caktohen në një marrëveshje të veçantë, të lidhur ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës Kombëtare Tregtare, Tiranë.

4. Shpenzimet për komisionin e shërbimit bankar, që do të kryhen pranë sporteleve të Bankës Kombëtare Tregtare, për shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, në shumën 100 (njëqind) lekë për çdo kreditor, e cila, në total, arrin vlerën 8 900 000 (tetë milionë e nëntëqind mijë) lekë, si dhe shuma 280 000 (dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë, për printimin e borxhit të shoqëria “DATECH” sh.p.k., Tiranë, sipas koeficientit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Kjo shumë, në vlerën 9 180 000 (nëntë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të shtohet në planin financiar, për vitin 2007, të Grupit Mbikëqyrës, zëri “shpenzime”.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Grupi Mbikëqyrës dhe administratori i pavarur i shoqërisë “Gjallica” sh.p.k., në administrim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha